


Zinxhiri i diturisë në sqarimin e çështjeve të metodologjisë (Menhexhit) – Pjesa 4

Tekfiri i Mushrikëve (2/2)

Falënderimi i takon All-llahut, përfundimi është për të devotshmit dhe armiqësia për të padrejtit. Dëshmoj se nuk ka Zot i cili mertion të adhurohet pos All-llahut i Vetëm i pa shok, Sunduesi i vërtetë dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i dërguari i Tij, imami i të parëve dhe të fundëve.

Në këtë pjesë me ndihmën e All-llahut do të flasim për për dy çështje:

E para: A është tekfiri i mushrikëve në një shkallë (pa dallime) apo dallon?

E dyta: Llojet e atyre që ndalen në tekfirin e mushrikëve.

Tashmë do të flasim rreth çështjes së parë, “A është tekfiri i mushrikëve në një shkallë (pa dallime) apo dallon?”

Përgjigje: Kanë përmendur dijetarët se tekfiri është dispozitë sheriatike e cila ndahet në kategori apo shkallë të ndryshme, varësisht dy çështjeve:

E para: Fuqia (shkalla) e vërtetimit të tij në sheriat, pra qartësia e argumentit sheriatik për kufrin e filan njeriut, e kjo është e njohur si ‘njohja e dispozitës’.

E dyta: Fuqia (shkalla) e vërtetësis së kësaj dispozite tek një person konkret i cili ka vepruar shirk apo kufër, e cila njihet si ‘njohja e gjëndjes’, e cila vërtetohet nëpërmjet shikimit, dëgjimit apo dëshmis së dëshmitarëve.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Tekfiri është dispozitë sheriatike e cila kthehet në lejimin dhe derdhjen e gjakut, gjykimi me përjetësi në zjarr, burimi i kësaj dispozite është i njëjtë me dispozitat tjera sheriatike. Ndonjëherë kuptohet me bindje, ndonjëherë nuk kuptohet bindshëm e ndonjëher ka pavendosmëri në çështje. Varësisht sa është prezente pavendosmëria (paqartësia e çështjes) ndalimi në tekfir është më parësorë. Nxitimi në tekfir paraqitet tek njerëzit tek të cilët mbizotëron injoraca." [1]

Kjo pra është e kundërta e atyre të cilët pretendojnë se të gjitha llojet e kufrit dhe shirkut janë në një kategori, në kuptimin e të cilave janë të barabartë edhe dijetari edhe injoranti, e nuk ka dyshim në josaktësinë e këtij mendimi i cili është në kundërshtim me atë që kanë pohuar dijetarët në këtë çështje apo është në kundërshtim edhe me citatet të cilat aludojnë se disa lloje të kufrit janë më të mëdha se disa të tjera.
Thotë i Lartëmadhëruari (kuptimi): **"...Në atë moment ata ishin më afër mosbesimit se besimit..."** [2] dhe thotë i Lartëmadhëruari (kuptimi):

1 Bug-Jetul Murtad, f. 345.
2 Surja Ali Imran, Ajeti 167.

"E shtyrja (e një muaji në vend të një tjetri) nuk është tjetër vetëm se një rritje e mosbesimit..." [3] dhe thotë i Lartëmdhëruari (kuptimi): **"...Ata të cilët bënë kufër pasiqë besuan dhe e shtuan kufrin e tyre..."** [4] dhe thotë i Lartëmadhëruari (kuptimi): **"Arabët beduin janë më të pajisur me kufër dhe hipokrizi..."** [5]

Kurse çështja në vijim (çështja e dytë) është, llojet e atyre që ndalen në tekfirin e mushrikëve.

Themi: Tek ata të cilët ndalen në tekfirin e mushrikëve kemi kategori të ndryshme, varësisht fuqisë së argumentit sheriatik dhe qartësis së kufrit dhe shirkut.

Thotë dijetari Muhamed ibn AbdulVehab, All-llahu e mëshiroftë: "Ata tagutët që njerëzit u besojnë atyre nga banorët e Kharxhit dhe të tjerë, janë të njohur tek të gjithë njerëzit, ata i zgjedhin (këta tagutë) dhe i urdhërojnë njerëzit në këtë, ata janë të gjithë kufar dhe të dalë nga Islami. Kush i mbron (këta tagutë) apo i'a tërheq vërejtjen atyre që bëjnë tekfir mbi ta (tagutët), apo mendon se edhe nëse vepra e tyre është e kotë megjithatë nuk i nxjerr ata për në kufër, më së paku gjëndja e këtij është fisku, nuk i pranohet dëshmija dhe nuk lejohet namazi pas tij.[6]

Pra medito në fjalën e tij, se si për atë që ndalet në tekfirin e këtyre tagutëve vendosi kategori, kategoria më e ulët fisku, e kjo edhe njëherë argumenton se ai që ndalet në tekfirin e mushrikëve ndahet në kategori të ndryshme.

Në këto kategori ndikon fuqia e argumentit sheriatik dhe qartësia e kufrit apo shirkut, pavarësisht forcës (sa i madh është) së tij. Ka mundësi që shirku të jetë më i madh në një gjendje prej gjendjeve, mirëpo në qartësi ai është më i paqartë se ndonjë shirk më i vogël.

3 Surja Teube, Ajeti 37.
4 Surja Ali Imran, Ajeti 90
5 Surja Teube, Ajeti 97.
6 Ed-Durar es-Sennije, v. 10, f. 52.

Një shembulli i kësaj: Shirku i adhuruesëve të statujave dhe shirku i Xhehmive.

Dispozita e tekfirit të atij i cili ndalet në tekfirin e adhuruesëve të statujave është më e fortë se dispozita e tekfirit të atij që ndalet në tekfirin e Xhehmive, e kjo për shkak se adhurimi i statujave është më i qartë se Xhehmizmi edhe pse Xhehmizmi është Shirk më i Madh.

Thotë Dijetari Ibn Kajim, All-llahu e mëshiroftë: "Mushriku i cili i pohon cilësit e Zotit është më i mirë se sa mohuesi i cilësive të plota. Si mund të krahasohet cënimi i cilësive të larta dhe mohimi i tyre me adhurimin i cili bëhet nëpërmjet ndërmjetësuesve, mes të adhuruarit të vërtetë dhe adhuruesit, afrohet tek ai nëpërmjet adhurimit të ndërmjetësuesit në shenjë madhërimi. Pra sëmundja e mohimit të cilësive (të All-llahut) është sëmundje e rëndë e cila nuk ka shërim." [7]

Dhe thotë All-llahu e mëshiroftë: "Shirku i adhuruesëve të statujave, të diellit, hënës, yjeve, është shumë më i mirë se "teuhidi" i atyre (mohuesëve të cilësive), për shkak se shirku i të parëve është shirk në uluhije duke e besuar Krijuesin e botës dhe duke i pohuar cilësitë, veprat, fuqinë, dëshirën e Tij, duke pohuar diturin e Tij absolute për të gjitha sendet, kurse teuhidi i atyre që mohojnë cilësitë është mohim i rububijes, uluhijes dhe cilësive të Tij të larta, e nga ky lloj "teuhidi" domosdoshmërisht ngërthehet lloji më i madh i shirkut, pra varësisht se sa njeriu i mohon (cilësit) aq më tepër thellohet ne shirk." [8]

Duke u bazuar në atë që përmendëm më lartë, tani do t'i përmendim kategoritë e atyre që ndalen në tekfirin e mushrikëve apo kafirëve, duke shikuar në qartësin e argumentit për kufrin e tyre duke u mbështetur në tekstet e dijetarëve.

7 Ed-Dau ve-Deva, f. 144.
8 Mukhtesar es-Savaik el-Mursele, f. 186.

Kategoria e parë: Kush ndalet (në tekfir) tek ata që kufri i tyre domosdoshmërisht është i njohur tek pasuesit e feve.

E para: Kush ndalet (në tekfirin) e Iblisit, Firaunit apo atij i cili pretendon se meriton të adhurohet (cilëson veten me uluhije) apo të tjerë.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për tekfirin e atij i cili nuk e bën tekfir Firaunin: "Domosdoshmërisht tek pasuesit e Feve, Muslimanët, Jehudët dhe të Krishterët është e njohur se Firauni është prej kafirëve më të mdhej prej krijesave." [9]

E dyta**:** Kush ndalet (në tekfirin) e adhuruesëve të statujave, edhe nëse përkatësohen në Islam.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për tekfirin e atyre që saktësojnë adhurimin e statujave: "Kush nuk i bën tekfir ata ai është jobesimtar më i madh se Jehudët dhe Krishterët, për shkak se edhe Jehudët edhe Krishterët i bëjnë tekfir adhuruesit e statujave." [10]

Thotë Ibn Vezir SanAni, All-llahu e mëshiroftë: "Nuk ka dyshim se kush dyshon në kufrin e adhuruesëve të statujave është obligim tekfiri i tij dhe tekfiri i atij i cili nuk e bën tekfir, e këtu nuk kemi ndonjë shkak tjetër pos që kufri i tyre është i njohur domosdoshmërisht në Fe." [11]

Ai që ndalet (në tekfir) në këtë kategori gjykohet me kufër, dhe nuk arsyetohet me injorancë në këtë çështje nëse atij i ka arritur argumenti Pejgamberik.

---

9 Mexhmu el-Fetava, v. 2, f. 125.
10 Mexhmu el-Fetava, v. 2, f. 128.
11 Er-Raud el-Baisi, v. 2, f. 509.

Kategoria e dytë: Kush ndalet (në tekfir) tek ata kufri i të cilëve domosdoshmërisht është i njohur në fenë e Muslimanëve në veçanti, si shembulli i atij i cili ndalet në tekfrin e Jehudëve, Krishterëve apo atij i cili e braktis fenë Islame.

Thotë Kadi Ijadi, All-llahu e mëshiroftë: "E bëjmë tekfir atë i cili nuk e bën tekfir personin i cili braktis Islamin dhe futet në një fe tjetër prej feve, abstenon apo dyshon apo saktëson medh'hebin e tyre." [12]

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Ai i cili pas Dërgimit të tij ﷺ, nuk e konsideron të ndaluar pasimin e fesë së Jehudëve apo të Krishterëve, nuk i bën tekfir dhe nuk i urren ata, ky person nuk është Musliman me pajtimin e të gjithë Muslimanëve." [13]

Ai që ndalet (në tekfir) në këtë kategori gjykohet me kufër, dhe nuk arsyetohet me injorancë në këtë çështje nëse atij i ka arritur argumenti Pejgamberik.

Kategoria e tretë: Kush ndalet (në tekfir) tek ata të cilët përkatësohen në Islam dhe kanë vepruar shirk apo kufër, ku është arritur konsensus për kufrin e vepruesit. Në këtë kategori kemi disa shkallë:

E para nga kategoria e tretë: Ai i cili nuk ka ndonjë shpjegim (te'vil), e këtij grupi njerëzish ose duhet t'u shpjegohet gjëndja e tyre (mushrikëve) ose duhet t'u shpjegohet dispozita e sheriatit për këta (mushrikë), ose duhet t'u shpjegohet edhe gjëndja edhe dispozita e sheriatit për këta (mushrikë që kanë vepruar shirk), e gjithë kjo duke u bazuar në qartësin e shirkut dhe qartësin e gjëndjes së këtyre (që kanë vepruar shirk). Nëse ndalet në tekfirin e tyre pas shpjegimit ai është kafir. Mirëpo nëse gjëndja e tyre (mushrikëve) është e qartë dhe dispozita e sheriatit mbi ta është e qartë, atëher gjykohet me kufër ai që nuk bën tekfir para se t'i shpjegohet (për shkak të qartësis së çështjes).

12 Esh-Shifa bi Ta'rif Hukuk el-Mustafa, v. 2, f. 286.
13 Mexhmu el-Fetava, v. 27, f. 464.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për një grup nga Batinit: "Kush ka mendim të mirë për ta dhe thotë se nuk e di gjëndjen e tyre, këtij i shpjegohet gjëndja e tyre (Batinive), e nëse nuk largohet prej tyre dhe nuk i kritikon apo nuk distancohet prej tyre haptazi, ky person e merr dispozitën e tyre (Batinive)." [14]

Shiko këtu se si Shejhul Islam ibn Tejmije për tekfirin e atij që ndalet në tekfirin e ketij grupi (Batinive) u mjaftua vetëm me shpjegimin e gjëndjes së tyre.

Thotë Shejh Sulejman ibn Abdila, All-llahu e mëshiroftë, për disa murtedë të kohës së tij: “Nëse ka dyshim në kufrin e tyre apo nuk ka njohuri për kufrin e tyre, këtij i shpjegohen argumentet nga libri i All-llahut dhe Suneti të Dërguarit të All-llahut ﷺ, për kufrin e tyre e nëse pastaj ka dyshim apo nuk është i vendosur, në këtë rast ai me pajtimin e gjithë dijetarëve është kafir, kjo për shkak se kush dyshon në kufrin e kafirit është kafir." [15]

Këtu vërejmë se shejhu Sulejman kushtëzon shpjegimin e dispozitës sheriatike për atë që ndalet (në tekfir), para se ta bëjnë tekfir atë (arsyetuesin).

Thotë Imam Ebu Hatim Er-Razi, All-llahu e mëshiroftë, për ata që kanë thënë se Kur’ani është i krijuar: “E kush kupton dhe nuk është injorant, pastaj dyshon në kufrin e tyre ai është kafir, kush është injorant i shpjegohet (mësohet) pastaj ose do të nënshtrohet duke i bërë tekfir ata ose domosdoshmërisht bie në kufër.” [16]

Në këtë rast Ebu Hatim e kushtëzon mësimin e atij që ndalet (në tekfir) para se ta bëjë tekfir atë (arsyetuesin që nuk bën tekfir).

14 Mexhmu el-Fetava, v 2, f. 132.
15 Ed-Durar es-Sennije, v 8, f. 160.
16 Tabakatul Hanabile, v. 1, f. 286.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për Hululitë: “Kush dyshon në kufrin e tyre pasi ta kuptojë thënien e tyre dhe ta kuptojë Islamin, ai është kafir, si ai që dyshon në kufrin e Jehudëve, Krishterëve dhe mushrikëve." [17]

Në këtë rast e ka kushtëzuar njohjen e gjëndjes dhe njohjen e dispozitës sheriatike.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për grupin e Druzëve: “Për kufrin e tyre nuk ka polemik mes Muslimanëve, përkundrazi kush dyshon në kufrin e tyre është kafir sikurse ata." [18]

Këtu vërejmë se në tekfirin e atij që ndalet (nuk i bën tekfir Druzët) nuk e ka kushtëzuar shpjegimin e gjëndjes e as shpjegimin e dispozitës, për shkak se edhe gjëndja e këtij grupi edhe argumentet për kufrin e tyre janë të qarta.

Lloji i dytë nga kategoria e tretë: Ai që ka bazat jo të mira dhe keqinterpreton, në gjykimin e këtij personi ndikon qartësia e madhe e kufrit të personit konkret apo grupimit. Në rastin kur kufri është shumë i qartë ai konsiderohet kafir, inatçor, këmbëngulës në keqinterpretimin e tij, e në raste tjera është polemizuar mes gjykimit në fisk apo kufër.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për një grup të Batinëve: “Kush thotë: Fjala e tyre ka një interpretim i cili përputhet me sheriatin ky person është prej kokave dhe dijetarëve të tyre, nëse ky person është inteligjent do ta kuptonte gënjeshtrën e vetës në atë që ka thënë në qoftë se është i bindur në këtë nga jashtë dhe brenda, i tilli është më jobesimtar se Krishterët. Kush nuk i bën tekfir ata dhe vendos ndonjë interpretim për fjalët e tyre atëherë do të jetë edhe më larg nga tekfiri i Krishterëve dhe besimi i tyre në trinitet." [19]

17 Mexhmu el-Fetava, v. 2, f. 368.
18 Mexhmu el-Fetava, v. 35, f. 162.
19 Mexhmu el-Fetava, v. 2, f. 133.

Dhe thotë, All-llahu e mëshiroftë: “Dhe nga ai (imam Ahmedi) për tekfirin e atij qe nuk i bën tekfir kemi dy transmetime, pra për tekfirin e atij qe nuk i bën tekfir Xhehmit, më e sakta është se nuk bën kufër." [20]

Thotë imam Buhariu, All-llahu e mëshiroftë: “Shikova në fjalët e Jehudëve, Krishterëve dhe Mexhusëve, dhe nuk vërejta fjalë më të keqija devijuese se fjala e tyre (pra Xhehmive) unë e konsideroj injorant atë që nuk i bën tekfir ata, pos atyre që nuk i’a dinë kufrin atyre." [21]

Shihet qartë se imam Buhariu anon në mos tekfirin e atij që nuk i bën tekfir Xhehmit siç transmetohet në njërën prej transmetimeve të imam Ahmedit.

Thotë Mirdavi, All-llahu e mëshiroftë: “Ka përmendur Ibn Hamid në Usulin e tij kufrin e Havarixhëve, Kaderive, Murxhive dhe tha: Kush nuk i bën tekfir ata që ne i kemi bërë tekfir, ai ka bërë fisk dhe duhet distancuar dhe në kufrin e tij kemi dy mendime. Këtë që e përmend ai dhe të tjerët pos tij prej Mervudhit, Ebu Talibit, Jakubit dhe të tjerëve, se ai (që ndalet në tekfir) nuk bën kufër...

Ai (ibn Hamid) për mohimin që Mutezilitë e bënë në nxjerrjen e zemrës së tij ﷺ natën e Isras dhe kthimin e saj (në trup) tha: ‘Në kufrin e tyre (Mutezilive për këtë mohim) kemi dy mendime, e gjithë kjo duke u bazuar në principet e tij për Kaderitë, të cilët e mohojnë diturin e All-llahut e cila është cilësia e tij. Dhe atë që thotë: Nuk i bëj tekfir ata që nuk bëjnë tekfir mbi Xhehmitë.” [22]

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: “Selefët dhe dijetarët nuk kanë polemizuar për mostekfirin e Murxhive dhe Shijave Mufadile (të cilët japin përparësi Aliut, All-llahu qoftë i kënaqur me të, duke mos i akuzuar të tjerët) dhe grupet tjera. Nuk ka kundërshtim në tekstet e imam Ahmedit se ai nuk i bën tekfir ata edhe pse ka prej

20 Mexhmu el-Fetava, v. 12, f. 486.
21 Khalk Af’al al-Ibad, f. 71.
22 El-Insaf fi Ma’rifah el-Raxhih min el-Khilaf, v. 1, f. 324.

pasuesve të tij që citojnë tekfirin e të gjithë grupeve të bidatit prej tyre dhe të tjerë, e kjo në kundërshtim me Ahmedin apo medh'hebin e tij, derisa disa prej tyre e përgjithësuan përjetshmërin e tyre dhe të tjerëve (në zjarr) e kjo është gabim në medh'hebin e tij dhe në sheriat." [23]

Lloji i tretë nga kategoria e tretë: Ai qe ka bazat të mira por ka keqinterpretim, siç transmetohet gabimi disa Sahabëve, All-llahu qoftë i kënaqur me ta, në tekfirin e disa murtedëve, ku All-llahu na shpjegoi gabimin e atyre që u ndalën (në tekfir) mirëpo nuk i gjykoi me kufër.

Nga Ibn Abasi, Allahu qoftë i kënaur me të se ka thënë: "Një grup nga banorët e Mekes e pranuan Islamin dhe e fshihnin atë. Këtë grup mushrikët e nxorën në Bedër (kundër Muslimanëve) ku disa prej tyre u plagosën e disa u vranë. Në këtë rast Muslimanët thanë: 'Ata ishin shokët tanë Muslimanë të cilët ishin nxjerrë me dhunë, kërkoni falje për ta'. Dhe pastaj zbriti ajeti (kuptimi): **"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të pa aftë në atë tokë!" (Engjëjt) Ju thanë: "A nuk ishte e gjërë toka e All-llahut e të migronit në të?" (e ta praktikonit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është Xhehenemi dhe sa vend i keq është ai!"** [24] Tha: Me këtë ajet një mesazh u dërgua tek kush mbeti prej Muslimanëve që nuk ka më arsye për ata. Tha: Ata pastaj u larguan (prej mushrikëve), por mushrikët i ndoqën dhe i kapën dhe i tërhoqën në fitne (i sprovuan). Prandaj, ky ajet: **"Ka prej njerzve që thonë 'ne besuam në All-llahun'…"** [25] u zbrit për ta.[26]

Thotë shejh Muhamed bin AbdulVehab, All-llahu e mëshiroftë: "All-llahu zbriti këtë ajet dhe në të sqaroi dispozitën e atyre mushrikëve sa ata janë banorë të zjarrit edhe pse kanë shprehur Islamin." [27]

23 Mexhmu el-Fetava, v. 3, f. 351.
24 Surja Nisa, Ajeti 97.
25 Surja Ankebut, Ajeti 10.
26 Taberiu në Tefsirin e tij, v. 9, f. 102.
27 Ed-Durar es-Senije, v. 10, f. 241.

Transmetohet se disa Sahabë polemizuan rreth tekfirit të disa murtedëve, e pasi që All-llahu e sqaroi kufrin e këtyre njerëzve nuk i urdhëroi ata të cilët nuk bënë tekfir që ta ripërtërijnë Islamin.

Thotë All-llahu i Lartmadhëruar (kuptimi): **"E çka është me ju që në çështjen e munafikëve jeni dy grupe; derisa për atë që bënë, All-llahu i përmbysi ata? A mos doni ta vini në rrugë të drejtë atë që All-llahu e ka humbur? Për atë që All-llahu e ka humbur, nuk do të gjeni rrugë!"** [28] Është saktësuar në shkakun e zbritjes së këtij ajeti se Pejgamberi ﷺ doli për në Uhud, disa që ishin me të u kthyen e në këtë rast shokët e Pejgamberit ﷺ u ndanë në dy grupe, disa thanë "t'i vrasim" e disa thanë "jo"." [29]

Transmetohet nga Muxhahidi se ka thënë: "Një grup nga populli i Mekes dolën prej Mekes dhe erdhën në Medine me supozimin se janë Muhaxhirë pastaj bënë ride (felëshim) dhe kërkuan leje nga Pejgamberi ﷺ që të shkojnë në Meke t'i marrin disa mallëra të tyre për tregti. Në këtë rast besimtarët polemizuan, disa thanë: Ata janë munafikë, e të tjerët thanë ata janë besimtarë. All-llahu e qartësoi nifakun e tyre dhe urdhëroi që të luftohen." [30]

Thotë imam Taberiu, All-llahu e mëshiroftë, në interpretimin e këtij ajeti: **"E çka është me ju që në çështjen e munafikëve jeni dy grupe; derisa për ata që bënë, All-llahu i përmbysi ata? A mos doni ta vini në rrugë të drejtë atë që All-llahu e ka humbur? Për atë që All-llahu e ka humbur, nuk do të gjeni rrugë!"** thotë: do të thotë: Se All-llahu i ktheu ata në dispozitën e mushrikëve, në lejimin e gjakut dhe robërimin e familjarëve." [31]

Imam Taberiu, All-llahu e mëshiroftë, ka mendimin se ky ajet ka zbritur për një grup të cilët bënë ride nga Islami, ku pasi që i përmend mendimet

28 Surja Nisa, Ajeti 88.
29 Buhariu dhe Muslimi.
30 Taberiu në Tefsirin e tij, v. 8, f. 9, 10052.
31 Tefsiri i Taberiut, v. 8, f. 7.

e Selefit për shkakun e zbritjes së këti ajeti, thotë: Prej këtyre mendimeve më parësorja që të jetë e vërtetë është mendimi se ky ajet ka zbritur për polemiken që patën shokët e të Dërguarit të All-llahut rreth grupit nga Meka që bënë ride (dalje) nga Islami pasi që kishin besuar." [32]

Thotë Ibn Ebi Zenenin (ky është nga dijetarët e hadithit): “Ishin grup i munafikave, në Medine, dolën prej aty për në Meke, pastaj prej në Meke për në Jemane si tregtarë, bënë ride (dalje) nga Islami dhe e shfaqen atë që kishin në zemra prej shirkut. Këtë grup e takuan Muslimanët të cilët u ndanë në dy grupe, disa thanë: “Hallall është gjaku i tyre, ata janë mushrikë, murtedë”, e disa thanë: “Nuk është hallall gjaku i tyre, janë grup të cilëve u është paraqitur sprova”. All-llahu i Lartëmadhëruar tha (kuptimi): **“Ç'është me ju, jeni ndarë në dy grupe rreth munafikave…”** [33]

Një grup nga ulematë kanë mendimin se Umeri, All-llahu qoftë i kënaqur me të, ndaloi në tekfirin e mosdhënësve të zekatit, e pasi që Ebu Bekri, All-llahu qoftë i kënaqur me të, i’a sqaroi kufrin e tyre (Umeri) u dakordësua. Në këtë rast nuk u kërkua (nga Umeri) që të pendohet për mostekfirin. Në transmetim të saktë përcillet se Umeri, All-llahu qoftë i kënaqur me të, i tha Ebu Bekrit rreth çështjes së murtedëve: “Si i lufton njerëzit? Kurse Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit deri sa të thonë La ilahe il-lAll-llah, kush e thotë atë, e ka të mbrojtur nga unë pasurin dhe veten e tij pos në të drejtën (e Islamit) e llogaria e tij i takon All-llahut."* [34]

Dispozita në këtë gjendje: Ai që ndalet (në tekfir/arsyetuesi) nuk bëhet tekfir fillimisht, porse gjykohet më gabim, kjo kështu duke u bazuar në atë se tekfiri është dispozitë sheriatike. Dispozita muxhtehidit i cili gabon në këtë çështje, është e njëjta me atë i cili gabon në çështje tjera sheriatike, nëse i sqarohen argumentet dhe largohet dyshimi (keqinterpretimi) dhe pastaj ndalet (në tekfir) atëherë ai është kafir.

32 Tefsiri i Taberiut, v. 8, f. 13.
33 Tefsiru Kuranil Aziz ibn Ebi Zenenin, v. 1, f. 393.
34 Buhariu dhe Muslimi.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: “Besimi për obligueshmërin e obligimeve të qarta të njohura dhe besimi për ndalimin e ndalesave të qarta të njohura, është prej bazave më të mëdha të imanit (besimit) dhe prej themeleve të fesë, ku mohuesi i tyre është kafir me pajtimin e të gjithëve, edhe pse muxhtehidi në disa prej tyre nuk është kafir me pajtimin e disave por gabimtar.” [35]

Thotë shejh Sulejman bin Sahman, All-llahu e mëshiroftë: “Pastaj nëse dikush prej dijetarëve ndalet nga të gjykuarit me kufër të ndonjërit prej atyre injorantëve pasues të Xhehmive apo injorantëve pasues të adhuruesve të varrezave, atëherë është e mundshme ta arsyetojmë atë me faktin se ai është gabimtar i arsyetuar, dhe nuk e gjykojmë atë me kufër për shkak se ai (arsyetuesi që ndalet në tekfirin e të lartpërmendurve) nuk është i mbrojtur prej gabimit dhe për këtë ka ixhma të prerë." [36]

Kategoria e katërt: Kush ndalet (në tekfirin) e atij që ka vepruar kufër apo shirk, por qëllimi i mostekfirit është qëllim sheriatik i lejuar, prej tyre:

1. Kush ndalet (në tekfirin) e atij që ka vepruar ndonjë lloj të shirkut apo kufrit për të cilën ka polemikë, se kjo vepër a të nxjerr prej feje apo jo, si lënësi i namazit.

2. Kush ndalet (në tekfirin) e atyre që përkatësohen në diturin sheriatike, me qëllim të largimit të tekfirit nga dijetarët Muslimanë.

Dispozita e arsyetuesit në këto dy raste është se i tilli është muxhtehid i shpërblyer me lejen e All-llahut, nëse ja qëllon i ka dy shpërblime nëse gabon e ka një shpërblim.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: “Largimi nga tekfiri i dijetarëve të Muslimanëve edhe nëse dikush largohet nga tekfiri

35 Mexhmu el-Fetava, v. 12, f. 496.
36 Keshful Euhan, f. 70.

i vepruesit me bindje se ai nuk është kafir, e gjithë këtë e vepron për ta mbrojtur dhe ndihmuar vëllain e tij Musliman, atëherë kjo vepër konsiderohet qëllim sheriatik i mirë. Nëse ai bën përpjekje (ixhtihad) dhe ja qëllon i ka dy shpërblime e nëse gabon e ka një shpërblim." [37]

Kemi një pyetje të rëndësishme: Në cilën kategori prej kategorive futet arsyetuesi i adhuruesëve të varrezave?

Përgjigje: Kategoria e arsyetuesit të varrexhive (që adhurojnë varreza) dallon varësisht qartësis së shirkut apo bindjeve për zotriun e varrit (të vdekurin). Ka prej tyre që i ngjason adhurimit të statujave. Apo edhe më tepër se aq, ka prej tyre që është më poshtë, ka prej tyre që është vetëm bidat në fe dhe nuk e arrin gradën e shirkut.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Kemi tre kategori në këtë kaptinë:

1. Të lusësh një të vdekur apo që nuk është prezent, pos All-llahut pa marrë parasysh a është ai Pejgamber apo të tjerë dhe të thotë: "O zotriu im më ndihmo, kërkoj mbrojtje prej teje, apo prej teje kërkoj ndihmë apo më ndihmo kundër armikut", e të ngjashme, dhe e gjithë kjo është shirk në All-llahun.

Më e keqe se kjo është të thotë: "Më fal mëkatin, dhe ma prano pendimin", siç e veprojnë këtë një grup prej xhahilave mushrikë.
Më e rëndë se kjo është "të bëjë sexhde dhe të falet drejt varrit të tij të besojë se drejtimi drejt (varrit) tij është më i mirë se drejtimi drejt kiblës, derisa disa prej tyre thonë: Kjo (drejtimi nga varri) është kibla e njerëzve të posaçëm, kurse Qabja është kibla e njerëzve të thjeshtë."

Më e madhe se kjo është: Të besojë se vizita e tij (varrit) është nga lloji i haxhit deri sa thotë: Vizita disa her e tij (të vdekurit) është e barabartë me një haxh. Gulatët (tepëruesit) prej tyre thonë: Vizita e tij (të vdekurit)

37 Mexhmu el-Fetava, v. 35, f. 103.

një herë është më me vlerë se sa kryerja e haxhit disa herë, e të ngjashme si kjo. Kjo është shirk, edhe pse shumë prej njerëzve bien në disa prej këtyre.

2. Që t'i thuhet të vdekurit apo atij që nuk është prezent prej pejgamberëve apo njerëzve të mirë: Lute All-llahun për mua, apo lute për neve Zotin tënd, apo kërko nga All-llahu për neve, siç të Krishterët i thonë Merjemes dhe të tjerëve, njëjtë edhe në këtë nuk duhet pasur mëdyshje nga çdo njeri i ditur se vepra e tillë nuk lejohet dhe se kjo është bidat të cilin nuk e ka vepruar askush prej Selefit.
Pra është e qartë se nuk lejohet të kërkohet diçka nga i vdekuri, nuk kërkohet nga ai ta lusë All-llahun apo diçka tjetër. Nuk lejohet që atyre t'i ankohemi për sprovat e dunjas dhe dinit. Edhe nëse është e lejuar t'i ankohemi atyre duke qenë gjallë, për shkak se kjo, duke qënë gjallë nuk të dërgon në shirk kurse kjo (të vdekurit) të dërgon në shirk.

3. Të thotë: Kërkoj prej Teje që për hir të filanit apo për hir të gradës që ka filani tek Ti apo e ngjashme me këtë. Përmendet nga Ebu Hanifja dhe Ebu Jusufi dhe të tjerë se kjo vepër nuk lejohet." [38]

Do të mjaftohemi me këtë, lusim All-llahun e Lartmadhëruar të na japë sukses, ndihmë dhe saktësi, mëshira e All-llahut qoftë mbi robin dhe të Dërguarin e Tij Muhamedin mbi familjen dhe shokët e tij.

Fundi i pjesës së katërt (4/6)
Përktheu: Ebu Lejth Albani

38 Mexhmu el-Fetava

